

4. AUDITIMI I BRENDSHËM

Funksioni i auditimit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë siguron mbarëvajtjen e zbatimit të ligjeve dhe akteve nënligjore në veprimtarinë e Bankës. Ai u siguron Administratorëve të Bankës dhe Këshillit Mbikëqyrës në mënyrë periodike dhe të pavarur, verifikimin dhe vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke testuar efektshmërinë e kontrolleve dhe procedurat e vendosura. Auditimi i brendshëm realizohet nga Departamenti i Kontrollit.

4.1. ZHVILLIME TË RËNDËSISHME NË AKTIVITETIN E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

A. Vënia në zbatim e politikës së auditimit të brendshëm

Procesi i shqyrtimit dhe miratimit të Planit vjetor të Auditimit të Brendshëm në Bankën e Shqipërisë, u realizua në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Plani vjetor për vitin 2024 u hartua nga Departamenti i Kontrollit dhe Inspektori i Përgjithshëm dhe u paraqit për shqyrtim nga Komiteti i Auditimit. Më tej, ky plan i dakorduar nga Komiteti i Auditimit, u miratua nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 52, në datën 6.12.2023.

B. Programi i vlerësimit të cilësisë së Auditimit të Brendshëm

Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm kërkojnë që një vlerësim i jashtëm i cilësisë (EQA) i aktivitetit të auditimit të brendshëm të kryhet të paktën një herë në pesë vjet nga një vlerësues i kualifikuar, i pavarur ose një ekip vlerësimi nga jashtë institucionit. Standardet gjithashtu kërkojnë kryerjen e një vetëvlerësimi periodik çdo 2 vjet.


Opinionin e përgjithshëm të vetëvlerësimit është: Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm të Bankës së Shqipërisë rezulton "Përgjithësisht në Përputhje"⁴⁰. Ky është vlerësimi më i lartë me Standardet e Institutit të Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe Kodin e Etikës sipas Manualit të Vlerësimit të Cilësisë të IIA. Ky nivel i përputhshmërisë demonstroi një qëllim dhe angazhim të qartë për arritjen e Parimeve Thelbësore për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe Përkufizimin e Auditimit të Brendshëm.

Në vijim evidentohen përmirësimet në praktikën e Auditimit të Brendshëm të Bankës së Shqipërisë, sipas vetëvlerësimit të fundit dhe vlerësimit të EQA 2020:

⁴⁰ Manuali i Vlerësimit të Cilësisë së IIA sugjeron një shkallë prej tre vlerësimesh, "Përgjithësisht në Përputhje", "Pjesërisht në Përputhje" dhe "Nuk në Përputhje".



Nivelet e përputhshmërisë sipas EQA	Standardet e vlerësuara gjatë IQA (2023)	Standardet e vlerësuara gjatë EQA (2020)
Nuk përputhet	0	0
Pjesërisht përputhet	0	3
Përgjithësisht përputhet	104	101
Vlerësimi i përgjithshëm	Përgjithësisht përputhet	Përgjithësisht përputhet
TOTALI	104	104




Vëzhgimet e adresuara nga ekipi vlerësues janë ndarë në dy kategori: Praktikën e Suksesshme të Auditimit të Brendshëm dhe Mundësitë për Përmirësim të Vazhdueshëm. Aktualisht, të gjitha rekomandimet e adresuara nga angazhimet për Vlerësimin e Cilësisë, janë zbatuar.

Gjatë vitit 2024, Instituti Global i Auditimit të Brendshëm publikoi standardet e reja të auditimit të brendshëm me datë zbatimi Janar 2025. Standardet e reja vijjnë me një riorganizim të ri për të qenë më të lehta në përdorim, i japin më tepër rëndësi rolit të qeverisjes dhe marrëdhënies së ndërsjellë midis drejtimit të lartë dhe funksionit të auditimit të brendshëm. Departamenti i Kontrollit planifikon që gjatë vitit 2025, të rishikojë kuadrin regullativ në përputhje me standardet e reja.


4.2. TREGUES TË PËRGJITHSHËM MBI DEPARTAMENTIN E KONTROLLIT

Në përputhje me Ligjin “Për Bankën e Shqipërisë”, statutin e Bankës së Shqipërisë, politikën dhe rregulloren e Auditimit të Brendshëm dhe rregulloren e Komitetit të Auditimit, struktura e Departamentit të kontrollit paraqitet sipas organigramës së mëposhtme me qëllim sigurimin e ruajtjes së objektivitetit, pavarësisë, integritetit të informacionit, përdorimit eficient të burimeve dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bankën e Shqipërisë.



A. Struktura organizative e Departamentit të Kontrollit

Struktura organizative e drejtuar nga Inspektori i Përgjithshëm jepet në vijim:




B. Rritja profesionale e stafit dhe trajnimi i vazhdueshëm

Në funksion të përmbushjes së objektivit strategjik për rritjen profesionale të audituesve të brendshëm, inspektorët e kontrollit janë përfshirë në programe trajnimi për auditimin e brendshëm dhe për menaxhimin e rrezikut të ofruara nga bankat qendrore. Ata gëzojnë tituj në certifikime profesionale si ACCA, CIA, CISA, si dhe kanë ndjekur orët minimale të detyrueshme për mirëmbajtjen e tyre.

4.3. ANGAZHIMET E KRYERA GJATË VITIT 2024 DHE PROBLEMATIKAT KRYESORE TË EVIDENTUARA

Angazhimet e auditimeve të kryera gjatë vitit 2024 janë fokusuar në dhënien e opinionit mbi mjaftueshmërinë e kontrolleve të brendshme të vendosura nga Drejtimi për funksionet/proceset e audituara, përfshirë dhe aplikacionet mbështetëse për kryerjen e aktiviteteve.

Gjatë vitit 2024 u adresuan gjithsej 26 rekomandime të rezultuara nga 11 angazhime auditimi për dhënie sigurie. Rekomandimet kanë adresuar kryesisht nevojën për përmirësimin e proceseve, sidomos në kuadër të përmirësimit të proceseve (70%); rishikimin e bazës rregullative (11 %) dhe të tjera mbi zbatimin e bazës rregullative (19%).



Gjetjet dhe rekomandimet për secilin prej auditimeve të realizuara gjatë kësaj periudhe janë adresuar fillimisht pranë drejtuesve të njësive për komente dhe, më pas pranë Administratorëve të Bankës së Shqipërisë dhe Komitetit të Auditimit.

